



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR PERIU DHËN KORRIK-SHTATOR 2024

Nr. R	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
10	03.07.2024	Kërkesë për informacion: A ka bashkia një venddepozitim për mbetjet urbane? Sa është nr. I stacioneve të transferimit të mbetjeve në bashkinë tuaj? A ka pika të tjera ilegale për grumbullin e mbetjeve? Sa %e territorit të bashkisë mbulohet nga shërbimi i grumbullimit? A keni një system apo keni marrë ndonjë nismë për kompostimin e mbetjeve? Sa është totali I volumit të mbetjeve në bashki? A keni një plan menaxhimi në fuqi të mbetjeve urbane ?	12.07.2024	Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e informimit ”ju bëjmë me dije se : Bashkia ka një venddepozitim për mbetjet urbane I cili ndodhet në fshatin Kash ,4 km nga qyteti i Ballshit në rrugën kombëtare Fier-Gjirokastrë . Në bashkinë tonë nuk ka pikë transferimi të mbetjeve. Nuk ka pika të tjera ilegale për grumbullin e mbetjeve. 73%e territorit të bashkisë mbulohet nga shërbimi I grumbullimit. Nuk janë ndërmarre nisma për kompostimin e mbetjeve. Sasia e mbetjeve të akumuluar nuk peshohet sepse nuk kemi peshore për matjen e volumit të mbetjeve.  Bashkia ka një plan vendor të menaxhimit të mbetjeve <a href="https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sq/aktivitete/plani-vendor-i-manaxhimit-t%C3%AB-integrUAR-t%C3%AB-mbetjeve">https://www.bashkiamallakaster.gov.al/sq/aktivitete/plani-vendor-i-manaxhimit-t%C3%AB-integrUAR-t%C3%AB-mbetjeve</a>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

<b>11</b>	<b>08.07.2024</b>	<p>Kërkesë për informacion:  Lista e digave ,barrierave dhe pritave që janë në shfrytëzim ,në fazë ndërtimi ,të planifikuara ose nën shqyrtim në basenet e Lumit Vjosë?  A jeni në dijeni të planeve që janë në process shqyrtimi apo zbatimi për ndërtimin e barrierave pritave apo diagve Brenda pellgut ujëmbledhës të lumit Osum po ashtu dhe në degëzimet e tyre deri në vitin 2030?  A ka ndonjë plan ceshtje në shqyrtim vendim apo process dekomisionimi për barrierat ,pritat apo digat që janë aktualisht në funksion të bujqësisë apo në shërbim të funksioneve të tjera ?</p>	<b>11.07.2024</b>	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e informimit ”ju bëjmë me dije : Aktualisht në basenin e lumit Vjosa në sipërfaqen që përshkon bashkinë Mallakastër janë ndërtuar barrierë që përmirësojnë erozionin e tokave në fshatin Hekal për të mbajtur në kontroll rrjedhjen e ujit për mos grryerjen e tokave që ndodhen afër lumit Vjosë. Këto barrierë janë ndërtuar në vitin 2020. Është kërkuar nga ana e bashkisë në institucionet përkatëse ndërtimi I barrierave në fshatin Çorrush.  Në lidhje me projektet e planifikuara për ndërhyrje në digat që ndodhen në zonën që përfshin baseni I lumit Vjosë ju informojmë se është planifikuar për tu zbatuar Brenda 1 viti rehabilitimi i digës së rezervuarit të Gadurovës.  Përsa I përket dekomisionimit të digave ose barrierave që janë aktualisht në funksion të bujqësisë apo në shërbim të funksioneve të tjera që janë në administrim të Bashkisë Mallakastër ,nuk ka asnjë plan apo ceshtje në shqyrtim apo vendim për heqje nga lista të digave që janë në funksion të bujqësisë apo funksioneve të tjera të cilat ndodhen në territorin e bashkisë Mallakastër.</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë
<b>12</b>	<b>09.07.2024</b>	<p>Kërkesë për informacion:  Të vihet në dispozicion plani i veprimit për eficientë e energjisë.  Cilët janë hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtij plani?  Nëse ky dokument nuk është hartuar ende ,cilat janë arsyet?  Cfarë hapash parashikohen të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin /hartimin e Planit te Veprimit për Eficencën e Energjisë?</p>	<b>19.07.2024</b>	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit ”Bashkia nuk disponon informacion në lidhje me planin e Veprimit për Eficencën e Energjisë .  Hapat që bashkia ka ndërmarrë sa I përket zbatimit të praktikave më të mira në kursimin e energjisë janë investimet e kryera ,si termoizolimi i 10 pallateve dhe ka vendosur sistem kapot në një qendër shëndetsore dhe në godinën e bashkisë e cila është kthyer në një godinë me parametra të rinj.</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë
<b>13</b>	<b>16.07.2024</b>	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” kërkohet informacion mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjinë hidrike HEC në</p>	<b>19.07.2024</b>	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit ", ju bejme me dije se :  Përgjatë periudhës 2008 e deri më sot në gjithë pjesën territoriale të Bashkisë Mallakastër nuk ka operuar asnjë subjekt në energjinë hidrike HEC dhe si rezultat nuk kemi investime në</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

		territorin e bashkisë suaj nga viti 2008 e deri më sot.		pyllezime etj.		
<b>14</b>	<b>07.08.2024</b>	<p>Kërkesë për informacion: Në mbështetje të interesit mbi sistemet e ujitjes dhe kullimit :</p> <p>Cilat janë skemat ujitëse ,digat,strukturat devijuese,puset ,veprat e marrjes,stacionet e pompimit të cilat përdorin ujin e lumit Vjosa për vaditjen e tokave bujqësore ? Sa është sasia e përgjithshme e ujit që merret (m3)? Sa është sasia e aluvioneve vjetore që del bashkë me ujin ? Cfarë mënyre përdorin për marrjen e ujit,rrjedhje të lirë apo pompim? Sa është nr i pritave argjinaturave të cilët janë ndërtuar përgjatë brigjevetë Vjosës për mbrojtjen e tokave nga erozioni apo shtëpitë nga përmytja</p>	<b>13.08.2024</b>	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 ‘Për te Drejtën e Informimit’ Ju bëjmë me dije se Bashkia Mallakastër nuk ka asnjë skemë ujitje që përdorin ujin e lumit Vjosa për vaditjen e tokave bujqësore . Në lumin Vjosa është ndërtuar një pritë që Bashkia Mallakastër në Njësinë administrative Hekalnë vendin e quajtur Mezarak e cila shërben për mbrojtjen e tokave fushë në fshatrat Hekal-Mollaj-Rromës nga erozioni apo gërryerja e Lumit Vjosa me një gjatësi prej 750m.</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë
<b>15</b>	<b>29.08.2024</b>	<p>Kërkesë për informacion: A hasni vështirësi gjatë rakordimeve mujore për përfitimin e rentës minerare,që ju takon sipas legjislacionin në fuqi? Mendoni se masa 5% e totalit të rentës që mblidhet është e mjaftueshme për bashkinë tuaj ?A keni kërkuar ndonjëherë që kjo vlerë të rritet duke marrë në konsideratë që vite më parë ka qenë në masën 25%</p>	<b>09.09.2024</b>	<p>Po haset vështirësi .Për arsye se nga institucionet tatimore dhe doganore nuk vjen informacioni I detajuar mbi sasinë e prodhimit të deklaruar nga operatorët ekonomikë për vendburimet e naftës që ndodhen në territorin e Bashkisë Mallakastër .U është kërkuar dhe operatorëve ekonomikë të na informojnë mbi sasinë e prodhuar dhe shitur nga vendburimet e territorit që administrojmë. 5% është nivel shumë I ulët në krahasim me atë që ekonomia e vendit dhe buxheti I shtetit merr nga të ardhurat që krijohen nga nëntoka e territorit që mbulon bashkia Mallakastër. Është kërkuar në takimet konsultative me punonjës të Ministrisë së linjës kur është diskutuar mbi ndryshimet në ligjin për taksat kombëtare dhe është kërkuar që kjo masë të jetë mbi 50%por nuk është reflektuar në ndryshimet e bëra .</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

		<p>A ken bërë ndonjëherë kërkesë për ndryshimin e procedurave mujore të rakordimit ?</p> <p>Si shpenzohen nga institucioni juaj paratë që përfitoni nga transfertat e rentës minerare?</p>		<p>Nuk është bërë kërkesë për ndryshimin e procedurave mujore të rakordimit .</p> <p>Bashkia Mallakastër të ardhurat nga renta minerare kryesisht I ka shpenzuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore , gjelbërimit në zonat naftë mbajtëse,dhe zonat ku kryhet shfrytëzimi I inerteve .Janë kryer investime në asfaltimin e rrugëve në disa fshatra si dhe bëhet periodikisht mirëmbajtja e rrugëve të tjera .</p>		
16	23.09.2024	<p>Kërkesë për informacion për rastin e 3 femijeve që jetojnë me Adriatik Kullollin dhe të ëmën e tyre.</p> <p>Na keni vënë në dijeni se keni dalë me një vendim se z.Kullolli është i rrezikshëm për fëmijët.</p> <p>Përse nuk po zbatohet vendimi? Cfarë masash keni marrë për rastin? A kanë takuar fëmijët psikologe? Cfarë ka rezultuar?</p>	27.09.2024	<p>Në bazë të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit ",kërkesës tuaj regjistruar me nr. 16 datë 23.09.2024 ju informojmë për rastin e Znj.L.SH dhe tre fëmijëve të mitur , se: Që nga momenti i referimit të rastit nga Bashkia e Bilishtit, në bazë të ligjit 18/2017 dhe VKM Nr. 578 datë 3.10.2018 janë ndjekur procedurat e menaxhimit të rastit nga punonjësja e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës, Bashkia Mallakastër. Në bazë të vlerësimit fillestar të rastit është thirrur dhe realizuar Grupi Teknik Ndersektorial (GTN) në datë 30.08.2024, në të cilën janë dakortësuar Planet Individuale të Mbrojtjes.</p> <p>Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues nga ; Sektori i Shërbimit Social,Komisariati i Policisë Mallakastër Zyra Vendore Arsimore,Vizion OJF</p> <p>Pjesë e këtij takimi gjithashtu kanë qënë dhe Znj.L.Sh dhe z .A.K. Gjatë diskutimit të rastit nga anëtarët e GTN-së u bë vlerësimi i nivelit të rrezikut për situatën e fëmijëve sipas përcaktimit ligjor, ku është vlerësuar rrezik i mesëm. z.A.K nuk është përcaktuar si person i rrezikshëm, por kushtet në të cilat ai jeton nuk janë të përshtatshme për të jetuar Znj.L.SH dhe tre fëmijët e mitur.</p> <p>Disa nga masat e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

janë; Monitorimi i vazhdueshëm në ambjentet ku fëmijët jetojnë. Ofrimin e një bonus qeraje në qytet, në mënyrë që të tre fëmijët të kenë kushte më të mira jetese.

Këto masa i janë komunikuar gjithashtu edhe z. A.K dhe znj.L.SH, të cilët parimisht kanë qënë dakort dhe kanë firmosur në procesverbalin e mbajtur.

Gjatë kësaj kohe është bërë monitorimi i vazhdueshëm i fëmijëve nëpërmjet vizitave të herëpashershme nga Sektori i Shërbimit Social dhe SPZ i zonës. Gjithashtu kemi qënë në kërkim të gjetjes së një banese me qera, banesë e cila u gjet por në momentin që rasti u bë mediatik, pati një tërheqje nga ana e pronarit të banesës për mosdhënien e saj me qera. Pavarësisht kësaj, jemi duke kërkuar një banesë me kushte të përshtatshme, megjithëse po hasim vështirësi.

Shërbimi Social vazhdon të menaxhojë rastin duke patur në fokus interesim më të lartë të fëmijëve.